

RRETHANAT SOCIO-POLITIKE DHE EKONOMIKE NË KOMUNËN E SUHAREKËS
1945-1990

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I HISTORISË

nga

BURIM IBALLI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTIT HISTORISË

Prishtinë

Maj, 2022

RRETHANAT SOCIO-POLITIKE DHE EKONOMIKE NË KOMUNËN E SUHAREKËS 1945-1990

Mentori: Prof. Dr. Bujar Dugolli

Në këtë punim është trajtuar ecuria e zhvillimeve socio-politike dhe ekonomike në komunën e Suharekës nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore e deri në periudhën e rënies së sistemit komunist (1945-1990). Zhvillimet politike dhe socio-ekonomike në këtë komunë në periudhën e sipërshënuar ndahen në tri faza: Faza e parë (1945-1966), karakterizohet me mungesë të zhvillimeve të përgjithshme, si pasojë e represionit jugosllav mbi popullsinë shqiptare, si dhe mungesën e vullnetit për të investuar në fusha të ndryshme në Kosovë; faza e dytë (1966-1981) përfshinë periudhën në të cilën për shkak të avancimit të pozitës kushtetuese të Kosovës, edhe jeta ekonomike, arsimore e kulturore ka shënuar një ngritje; dhe faza e tretë (1981-1990), karakterizohet me mungesë të zhvillimeve në të gjitha drejtimet, për shkak të masave që ka ndërmarrë pushteti i Beogradit ndaj demonstratave të mars-prillit 1981.

Qëllimi i trajtimit të kësaj problematike është hedhja dritë mbi zhvillimet socio-politike dhe ekonomike në komunën e Suharekës në gjysmën e dytë të shek. XX, ngase në historiografinë shqiptare ende nuk kemi ndonjë studim monografik për këtë çështje, ndonëse në studime të përgjithshme hasën të dhëna me interes për këtë komunë.

Për të qenë sa më mirë i organizuar këtë punim e kemi ndarë në katër kapituj, ku janë trajtuar çështjet duke respektuar aspektin kronologjik.

Kapitulli i parë titullohet: **“Zhvillimet socio-politike dhe ekonomike në komunën e Suharekës në periudhën 1945-1966”**. Në këtë kapitull si fillim gjejmë të trajtuar zhvillimet politike në komunën e Suharekës në periudhën nga Kuvendi i Prizrenit deri te rënia e Rankoviqit në Plenumin e Brionëve (1945-1966). Studimi vazhdon me një vështrim që u është bërë rrethanave të përgjithshme ekonomike, arsimore e kulturore që kanë karakterizuar Kosovën në përgjithësi dhe Suharekën në veçanti në vitet e sipërshënuara. Gjithashtu, në këtë kapitull gjejmë të dhëna dhe materiale me rëndësi mbi formën e dhunës dhe terrorit shtetëror të Jugosllavisë ndaj shqiptarëve në këtë komunë. Kjo është periudhë në të cilën në mënyrë sistematike pushteti i Beogradit ka ushtruar tryzni ndaj popullsisë shqiptare. Por, megjithatë janë shënuar edhe hapa në drejtim të zhvillimeve të përgjithshme, ndonëse jo në masën e nevojshme.

Kapitulli i dytë titullohet: **“Rrethanat politike, ekonomike dhe sociale në komunën e Suharekës 1968-1990”**. Në këtë kapitull janë trajtuar në hollësi ndryshimet kushtetuese (1966-1974) dhe efektet e tyre në komunën e Suharekës. Është periudhë në të cilën rrethanat socio-politike dhe ekonomike e kulturore kanë qenë më të favorshme për zhvillimet e përgjithshme në Kosovë dhe natyrisht edhe në komunën e Suharekës. Në fokus të trajtimit dhe analizës ky kapitull ka edhe karakteristikat e zhvillimit ekonomik, arsimor e kulturor në vitet 70-të. Sa i përket zhvillimit ekonomik, komuna e Suharekës arriti sukseset më të mëdha, me hapjen e fabrikave si fabrika e gomës “Ballkan”, fabrika e pijeve alkoolike dhe joalkoolike “Schëepes”, etj, në të cilat u punësuan mijëra punëtorë. Po ashtu, në vitet 70-të, krahas ndërtimit dhe hapjes së shkollave të reja fillore, u hapën edhe dy shkolla të mesme. Mirëpo, pas demonstratave të mars-prillit 1981, si tërë Kosova, edhe komuna e Suharekës për shkak të acarimit të gjendjes politike pësoi stagnim në të gjitha fushat.

Kapitulli i tretë titullohet: **“Format e rezistencës së shqiptarëve ndaj pushtetit jugosllav”**. Në këtë kapitull ofrohen të dhëna me interes mbi çështjen e formave të rezistencës së shqiptarëve ndaj pushtetit jugosllav, duke filluar me organizimin dhe veprimtarinë e organizatave ilegale në komunën e Suharekës dhe zhvillimin e demonstratave në këtë komunë në vitet 1968, dhe 1981. Suhareka ishte shndërruar në një bazë të veprimtarëve të çështjes kombëtare, të cilët kordinonin me komunat e tjera, si Prizrenin, hapat e duhur me qëllim zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Shembull për këtë është organizimi i demonstratave të vitit 1968, ku dy ditë pas Prizrenit u zhvilluan edhe në Suharekë, duke u bërë kështu qyteti i dytë në Kosovë që organizoi demonstrata kundër pushtetit jugosllav. Në fund të këtij kapitulli është përfshirë mënyra e përndjekjes, arrestimit dhe burgosjet e intelektualëve shqiptarë të kësaj komunenga ana e pushtetit të Beogradit, si pasojë e aktiviteteve të tyre politike gjatë viteve 1945-1990.

Kapitulli i katërt titullohet: **“Suprimimi i autonomisë së Kosovës dhe përdorimi i dhunës dhe terrorit shtetëror në Kosovë, respektivisht në komunën e Suharekës 1989-1990”**. Në këtë kapitull që është i fundit është trajtuar çështja e suprimimit të autonomisë së Kosovës dhe reflektimi në jetën politike të komunës së Suharekës, e cila si tërë Kosova, pati pasoja të mëdha në fushën politike, ekonomike e kulturo-arsimore. Në fushën politike pasojat ishin të mëdha, për shkak se jeta politike u paralizua në tërësi, ndërsa klasa politike shqiptare u përjashtua nga të gjitha funksionet politike e shtetërore, qoftë në nivelin komunal, po ashtu edhe në atë qendror. Përjashtimi i shqiptarëve nga pozitave politike, menagjeriale e nga vendet e tyre të punës, tashmë

ishte bërë dukuri e zakonshme për pushtetin jugosllav. Pra, janë trajtuar gjithanshëm masat e dhunshme nga aparati shtetëror serbo-jugosllav në fushën politike, ekonomike, arsimore e kulturore, si dhe dhuna dhe terrori ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë, respektivisht në komunën e Suharekës 1989-1990. Kjo ishte arsyeja që shqiptarët vendosën të shpallnin Republikën e Kosovës dhe kështu të krijonin institucionet e tyre paralele në fillim të viteve 90-të.

Në përfundim, mund të themi se studimi ndihmon lexuesit që të kuptojnë më qartë zhvillimet socio-politike dhe ekonomike në mënyrë specifike në komunën e Suharekës, por ndihmon për t'u njohur edhe me rrethanat e përgjithshme në Kosovë në vitet 1945-1990. Jeta politike pësoi ngritjet dhe uljet në varësi nga rrethanat e jashtme dhe çasja e Federatës Jugosllave në relacion me Kosovën. Kjo vërtetohet më së miri në periudhën 1945-1966 dhe 1981-1990. Në këto dy faza pushteti jugosllav ishte më i ashpër ndaj shqiptarëve dhe të drejtave të tyre. Rrjedhimisht edhe zhvillimi socio-ekonomik pësonte ulje, si pasojë e acarimit të gjendjes politike. Ndërsa, periudha e ndërmjetme (1966-1981) është karakterizuar me zhvillime të përgjithshme nga të gjitha fushat, si në fushën politike: ngritja e pozitës kushtetuese të Kosovës, që arriti zenitin më 1974, pastaj fushën ekonomike: ngritja e dhjetra fabrikave gjithandej vendit, duke përfshirë edhe komunën e Suharekës, në të cilën u hapën fabrika me rëndësi jetike për ekonominë e kësaj komune, fushën arsimore e kulturore: ku përveç Universitetit të Prishtinës, janë hapur me dhejtra shkolla fillore, të mesme dhe të larta në gjithë Kosovës. Po ashtu, shumë institucione, arsimore, kulturore dhe shkencore kanë filluar punën në vitet 70-të.